



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/273
Datë: 31.10.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 tetor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen Ekstrakti i Procesverbalit dhe Transkripti të mbledhjes së 270-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjeve: 271 dhe 272 Elektronike/Korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PEN
Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/273
Datë: 31.10.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 dhe 31 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 22 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 tetor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2026.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/273

Datë: 31.10.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 11, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 tetor 2025, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme, ish-shoqërore për nevoja të institucioneve qendrore të sigurisë së Republikës së Kosovës, Zona Kadastrale Atmaxhë - Komuna Prizren dhe Zona Kadastrale Banjë - Komuna Malishevë, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij Vendimi është Raporti i Vlerësimit, i punuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabela e bashkëngjitur këtij Vendimi, në të cilën është përcaktuar shuma e kompensimit për tokën për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit ua dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike, kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente, vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente, parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës do ta paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit të caktuar në aktin e vlerësimit, i cili është pjesë e këtij Vendimi, konform legjislacionit në fuqi.
8. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratin e shpronësimit) të tij, paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Zyra Kadastrale Komunale është e obliguar t'i kryejë veprimet procedurale për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/273
Datë: 31.10.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 62, paragrafi 4, të Ligjit N. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063, dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 tetor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e komunave: Prishtinë, Gjiilan dhe Zubin-Potok për aprovimin e Buxhetit, pas miratimit të Buxhetit për vitin 2025 nga kuvendet komunale.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin së bashku me tabelat t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe komunat: Prishtinë, Gjiilan dhe Zubin-Potok, për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Për [Signature]

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/273

Datë: 31.10.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 tetor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Mbështetjes Publike Financiare për Skenën e Pavarur Kulturore.
2. Obligohen Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/273
Datë: 31.10.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15 paragrafit 5, të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 tetor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për kursime dhe ndarje, sipas tabelave të bashkangjitura në aneksin A (Kursimet) dhe në aneksin B (Ndarjet).
2. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

për

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Aneksi A (Kursimet)

BILLOKU KODUES	ORGANIZATA	PROGRAMI	KAT	KATEGORIA	Shuma
10104.12400.13.00000.0132	ZYRA E KRYEMINISTRI	AGJENCIA E STATISTIKAVE TE KOSOVES	13	MALLERA DHE SHERBIME	800,000.00
10102.10500.13.00000.0111	ZYRA E PRESIDENTIT	ZYRA E PRESIDENTIT	13	MALLERA DHE SHERBIME	200,000.00
Total -Kursime					1,000,000.00

Aneks B (Ndarjet)

BLLOKU KODUES	ORGANIZATA	PROGRAMI	KAT	KATEGORIA	SHUMA
10.232.13100.38/000000112	SIHPENZIMET E PAPARASHIKUARA	SIHPENZIMET E PAPARASHIKUARA	38	REZERVA	1.000.000,00
Total -Ndarje					1.000.000,00



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/273
Datë: 31.10.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 14, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 tetor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 40,000.00€ (dyzetë mijë eurosh), për meremetimin e kulmit të Kullës III në Rrugën "Ali Viti" - Emshir, Prishtinë, pas dëmtimit nga zjarri.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga "Shpenzimet e paparashikuara", me kod 232, nënprogrami "Shpenzimet e paparashikuara", me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva" dhe transferohen në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, në nënprogramin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe transfere".
3. Obligohet Thesari që ta realizojë transferin e mjeteve, sipas pikës 1. të këtij Vendimi, në llogarinë bankare të caktuar dhe të autorizuar nga Këshilli Banesor, sipas kërkesës së bashkangjitur këtij Vendimi.
4. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PER
Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/273
Datë: 31.10.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-176 dhe Ligjin Nr.08/L-248, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 tetor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rritja e shumës së përfitimit të skemave pensionale të financuara nga shteti duke filluar nga muaji nëntor 2025, për skemat dhe nënprogramet si në vijim:
 - 1.1. Pensionet bazike – sociale, nga shuma aktuale prej njëqind e njëzetë euro (120.00€) në shumën prej njëqind e pesëdhjetë euro (150.00€), me kod buxhetor 00100;
 - 1.2. Skema e fëmijëve me aftësi të kufizuar 1-18 - nga shuma aktuale prej njëqind e njëzetë euro (120.00€) në shumën prej njëqind e pesëdhjetë euro (150.00€), me kod buxhetor 00600;
 - 1.3. Pensionet e aftësisë së kufizuar - nga shuma aktuale prej njëqind e njëzetë euro (120.00€) në shumën prej njëqind e pesëdhjetë euro (150.00€), me kod buxhetor 00200;
 - 1.4. Pensioni familjar - nga shuma aktuale prej njëqind e njëzetë euro (120.00€) në shumën prej njëqind e pesëdhjetë euro (150.00€), me kod buxhetor 02900;
 - 1.5. Pensioni invalidor i punës - nga shuma aktuale prej njëqind e njëzetë euro (120.00€) në shumën prej njëqind e pesëdhjetë euro (150.00€), me kod buxhetor 03000;
2. Për të mbuluar koston e rritjes sipas pikës 1. të këtij Vendimi, aprovohet ndarja të mjeteve buxhetore në shumë prej njëmbëdhjetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind euro (11,466,900.00€).
3. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga nënprogrami “Programi i Ringjalljes Ekonomike” me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve “Subvencione dhe Transfere” dhe transferohen në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, në nënprogramet si vijon:
 - 3.1. Pensionet bazike – sociale me kod 00100, shuma prej 9,776,820.00 euro.
 - 3.2. Pensionet e aftësisë së kufizuar me kod 00200, shuma prej 1,298,100.00 euro.
 - 3.3. Pensioni familjar me kod 02900, shuma prej 152,580.00 euro.
 - 3.4. Pensioni invalidor i punës me kod 03000, shuma prej 1,800.00 euro
 - 3.5. Skema e fëmijëve me aftësi të kufizuara 1-18 me kod 00600, shuma prej 237,600.00 euro.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/273
Datë: 31.10.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 23 paragrafit 1, të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i plotësuar dhe i ndryshuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 31/99 të datës 30.09.2022, Vendimin Nr.20/140 të datës 26.04.2023 dhe Vendimin Nr. 23/159 të datës 13.09.2023, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 tetor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 10,000,000.00€ (dhjetë milionë euro), me qëllim rritjen e vlerës së Shtesave për Fëmijë për pesëdhjetë për qind (50%) mbi vlerën aktuale, duke filluar nga muaji nëntor 2025.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe transferohen në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, në nënprogramin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

për 
Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/273
Datë: 31.10.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 57 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-142 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale, Procedurat e Caktimit të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të Ardhurat Personale Vjetore, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 tetor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për përcaktimin e pagës minimale në Republikën e Kosovës, si vijon:
 - 1.1. Duke filluar nga data 1 janar 2026, në nivelin prej 2.50€ (dy euro e pesëdhjetë centë) për një orë pune të rregullt, apo ekuivalent me 425.00€ (katërqind e njëzet e pesë euro) bruto në muaj për punë me orar të plotë.
 - 1.2. Duke filluar nga data 1 korrik 2026, në nivelin prej 3.00€ (tre euro) për një orë pune të rregullt, apo ekuivalent me 500.00€ (pesëqind euro) bruto në muaj për punë me orar të plotë.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Inspektorati i Punës për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

për 
Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 11/273
Datë: 31.10.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafit 2, të Ligjit Nr. 04/-L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 tetor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes së Grantit për Shërbime Ekspertësh në Sektorin e Energjisë dhe Klimës për Kosovën, ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe KfW, Frankfurt m Main.
2. Përgjatë negocimit të kësaj Marrëveshjeje, Ministria Financave, Punës dhe Transfereve obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, si dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë